

Vendim nr. 99 datë 11.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 11.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (S) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SKËNDER FRASHËRI,**
EJVIS NUESSEIN (FRASHËRI)

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 129, datë 21.01.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 12, datë 07.02.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2022-2152, datë 28.09.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të babait të tyre, të ndjerit R.F., i cili ka qenë trashëgimtar ligjor i së ndjerës N.V. (F). Kjo e fundit ka qenë subjekt i ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, në bazë të të cilit ka dalë vendimi nr.

75, datë 21.03.1995 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Vlorë (KKKP, Vlorë), që vendoste njohjen e saj pronar të një sipërfaqeje trualli prej 6600 m² dhe kompensimin për sipërfaqen e truallit 5000 m², sipas disponibilitetit të komisionit. Babai i kërkesve i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 2725, datë 09.11.1995, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 75, datë 21.03.1995 të KKKP-së, Vlorë, duke i kthyer në natyrë atij sipërfaqen 3131 m², ndërsa diferenca prej 3469 m² kompensohej sipas disponibilitetit të komisionit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 1874, datë 29.03.1996.

2. Me pretendimin se një pjesë e kësaj sipërfaqeje toke kishte mbivendosje me pronën e tij, shtetasi S.A. në datën 27.04.2005 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 75, datë 21.03.1995 të KKKP-së, Vlorë. Kjo kërkesëpadi është pushuar me vendimin nr. 128 akti, datë 20.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse në këtë proces. Në vijim, shtetasi S.A. i është drejtuar sërish kësaj gjykate në datën 25.10.2005 me kërkesëpadi me të njëjtin objekt.

3. Paralelisht edhe babai i kërkesve R.F. ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt lirim dhe dorëzimin e truallit me sipërfaqe 1131 m².

4. Për kërkesëpadinë e R.F., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 351, datë 13.04.1999, ka vendosur: *“Pranimi i padisë së R.F. duke detyruar të paditurin S.A. të lirojë truallin duke prishur murin rrethues që ka bërë mbi këtë truall. Rrëzimin e padisë për sipërfaqen 522.5 m² të zënë nga i padituri me ndërtimin e objektit në ish pronën e N.V.”.*

5. Mbi ankimin e të dyja palëve ndërgjyqëse, me vendimin nr. 474, datë 14.09.1999, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 351, datë 13.04.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me saktësimin *“Rrëzimin e padisë për sipërfaqen 627 m² truall.”.*

6. Me vendimin nr. 1322, datë 27.11.2000, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Kundër vendimeve të mësipërme ka paraqitur rekurs në interes të ligjit, në bazë të nenit 473 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), babai i kërkesve R. F., i cili ka kërkuar prishjen e vendimeve dhe pranimin e padisë, pasi vendimet janë dhënë në kundërshtim me ligjin.

7. Mbi rekursin në interes të ligjit, me vendimin nr. 54, datë 26.9.2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 1322, datë 27.11.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe vendimit nr. 474, datë 14.09.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë, me tjetër trup*

gjykues”, me argumentin se gjykatat kishin zbatuar gabim ligjin material, duke i lënë detyra Gjykatës së Apelit Vlorë të verifikonte mënyrën e fitimit të pronësisë të shtetasit S.A.

8. Ndërkohë, R.F. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me një tjetër kërkesëpadi me objekt: *“Pavlefshmëri e kontratës së shitjes nr.2004 rep., datë 18.10.1996. Fshirja nga regjistrat e Hipotekës Vlorë e evidentimit nr.224, datë 01.06.1992 të 300 m² truall dhe nr.225, datë 01.06.1992 të 300 m² truall dhe e sipërfaqes prej 874 m² truall e evidentuar me nr.3193, datë 18.10.1996, lirimi dhe dorëzimi i këtij trualli. Detyrimin e të paditurve të njohin pronar paditësin mbi një sipërfaqe prej 5.000 m² truall të ndodhur në Fabrikën e Tullave Vlorë.”*. Me vendimin nr. 417, datë 26.04.2000, kjo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

9. Me vendimin nr. 209, datë 22.04.2005, Gjykata e Apelit Vlorë, pas shqyrtimit të çështjes pas dërgimit të saj me vendimin nr. 54, datë 26.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr.417, datë 26.04.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në këtë mënyrë: Pranimin e pjesshëm të padisë. Duke konstatuar pavlefshmërinë absolute pjesërisht të kontratës së truallit me nr.2004 rep., datë 18.10.1996 të noterit A. Xh., lidhur mes të paditurit Seksioni i Financës së Bashkisë Vlorë si shitës dhe të paditurit S. A. si blerës, për pjesën prej 399 m², urdhërohet kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme. Fshirjen e pjesshme të regjistrimeve të dy sipërfaqeve nga 300 m² secili, me nr.224 dhe nr.225 datë 01.06.1992 të bëra në Hipotekën Vlorë, për pjesët respektivisht prej 11.4 m² dhe 268 m² që mbivendosen me pronën e paditësit. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.”*.

10. Me vendimin nr. 1233, datë 02.11.2006, Gjykata e Lartë ka prishur vendimet nr. 209, datë 22.04.2005 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr. 417, datë 26.04.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke e dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe orientuar bashkimin e kësaj çështjeje me çështjen për gjykim midis shtetasit S.A. dhe të paditurve AKKP-ja, Vlorë e R.F. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka lënë detyra për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë për të verifikuar nëse realisht ka mbivendosje apo pronat nuk përputhen me njëra-tjetrën, si dhe sa është në fakt mbivendosja, në qoftë se ka të tillë.

11. Në rigjykim, me vendimin e datës 21.03.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur bashkimin e çështjeve me paditës R.F. dhe të paditur S.A., me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes, me çështjen me paditës S.A., me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 75, datë 21.03.1995 të KKKP-së, Vlorë. Ndërsa me vendimin jopërfundimtar të datës 10.01.2008, kjo gjykatë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes nr. 829, datë 19.02.2007, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes dhe vazhdimin e gjykimit për padinë me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 75, datë 21.03.1995 të KKKP-së, Vlorë.

12. Me vendimin nr. 129, datë 21.01.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: *“Të pranojë kërkesëpadinë e paditësit S.A. kundër të paditurit Agjencia Rajonale e Kthimit e Kompensimit të Pronave Vlorë, e R. F. Të anulojë pjesërisht vendimin nr. 75, datë 21.03.1995 të K.K.K.P. Vlorë, ndryshuar me vendimin nr.2725, datë 09.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.1874, datë 29.03.1996, për sa i përket njohjes dhe kthimit në natyrë të sipërfaqes 1113 m² që mbivendoset me pronën e paditësit S. A., siç është paraqitur grafikisht në aktin e ekspertimit datë 27.11.2007.”*, me arsyetimin se sipas akteve të ekspertimit rezulton se prona që i është kthyer R.F. nuk është prona e trashëgimlënësve të tij, por ish-pronë shtetërore. Gjithashtu, ajo pronë nuk ishte truell i lirë, por ishte zënë në vitin 1992 nga S.A. i cili në përputhje me ligjin kishte blerë 600 m² e më pas në vitin 1996 i ishte dhënë sheshi i ndërtimit për 874 m². Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim R.F.

13. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 303, datë 22.10.2008, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr.129, datë 21.01.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kthimin e çështjes për rigjykim, në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.”*, pasi gjykimi i çështjes kishte filluar pa u shpallur trupi gjykues dhe gjykata nuk kishte formuar drejt ndërgjyqësinë pas bashkimit të çështjeve. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk i kishte komunikuar R.F. pushimin e gjykimit të padisë së ngritur prej tij dhe vazhdimin e gjykimit të padisë së S.A.

14. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 592, datë 12.12.2012, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 303, datë 22.10.2008 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues”*, me arsyetimin se në ndryshim nga sa ka argumentuar Gjykata e Apelit Vlorë, është shpallur trupi gjykues, është përcaktuar saktë pozicioni procedural i palëve ndërgjyqëse, si dhe vendimet për pushimin e padisë dhe vazhdimin e gjykimit në mungesë të R. F. janë marrë në përputhje me nenin 179 të KPC-së.

15. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 12, datë 07.02.2014, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 129, datë 21.01.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.”*, me të njëjtën linjë arsyetimi të vendimit nr. 129, datë 21.01.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs pala e paditur, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (sot Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP)) dhe kundërrekurs S.A.

16. Me vendimin nr. 00-2022-2152, datë 28.09.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur ATP-ja kundër vendimit nr. 12, datë 07.02.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë, me argumentin se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së dhe se pretendimet që ngrenë çështje

të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të asaj gjykate.

17. Në datën 30.01.2023 kërkesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili është plotësuar në datën 13.02.2023, për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, sipas objektit, si të papajtueshme me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkesve

18. Kërkesit kanë pretenduar se vendimet objekt kërkesë u kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

- 18.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi babait të kërkesve i është njohur dhe kthyer prona dhe më pas i është rimarrë nga shteti, duke ia shitur një subjekti tjetër, megjithëse titulli i pronësisë pranohet që është i rregullt dhe nuk krijonte mbivendosje.
- 18.2. *Së drejtës së ankimit efektiv dhe së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata*, pasi babait të kërkesve nuk i është komunikuar në kohë dhe në mënyrë të qartë vendimi i gjykatës së apelit dhe vendimi i pushimit të gjykimit të çështjes së ngritur prej tij në shkallë të parë.
- 18.3. *Së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në rekurs, duke krijuar bindjen se ato nuk janë vlerësuar nga kjo gjykatë.
- 18.4. *Së drejtës së pronës*, pasi shitja e truallit nga ana e shtetit përbën në thelb shpronësim pa ligj të pronës së kthyer pronarit të ligjshëm, pasi sipas ligjit nr. 7693, datë 06.04.1993 “Për urbanistikën” në rastet kur nuk ishte realizuar ndërtimi (për të cilin ishte dhënë trualli dhe leja e ndërtimit) deri në momentin e ndryshimit të këtij ligji me ligjin nr. 7820, datë 24.04.1994, personave që kishin blerë dhe regjistruar në emër të tyre troje, iu kthehej vlera e indeksuar e paguar, ndërsa trojet ktheheshin në pronësi “shtet” për t'u trajtuar në vijim. Shtetasi S.A. e ka kryer ndërtimin në kohën që zhvillohej gjykimi dhe e ka kryer blerjen nga shteti pasi trualli i ishte kthyer fizikisht pronarit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesve

19. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

20. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

21. Në këndvështrim të verifikimit të plotësimi të këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi janë trashëgimtarë të palës së paditur në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

22. Shterimi i mjeteve juridike efektive është një tjetër kriter që duhet të përmbushet nga individi përpara se t’i drejtohet Gjykatës. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll *subsidiar*, që do të thotë se individi duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt, bëhet i mundur kur kërkuuesi të ketë shteruar mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimin nr.3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në drejtim të shterimit të mjeteve, Kolegji konstaton se kërkuuesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Me vendimin nr. 129, datë 21.01.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së paditësit në atë gjykim, duke anuluar pjesërisht

vendimin nr. 75, datë 21.03.1995 të KKKP-së, Vlorë, i cili kishte njohur si pronar babanë e kërkuësve. Në vijim edhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 12, datë 07.02.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi rezulton se ka paraqitur rekurs pala e paditur, ATP-ja dhe kundërrekurs S. A., por jo babai i kërkuësve.

24. Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për nevojat e këtij gjykimi kushtetues, Kolegji vëren se për sa i përket njoftimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, babai i kërkuësve ka refuzuar të marrë në dorëzim kopjen e vendimit, gjë e cila vërtetohet nga dëftesa e komunikimit e datës 13.03.2014. Nga aktet nuk rezulton që ai të ketë marrë dijeni për rekursin e ATP-së. Për sa i përket kundërrekursit të paraqitur nga S.A., babai i kërkuësve ka marrë dijeni personalisht në datën 13.06.2014. Gjithashtu, nga dosja gjyqësore rezulton se me vendimin e datës 12.04.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur revokimin e vendimit të caktimit në seancë gjyqësore dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomë këshillimi, mbi bazë të dokumenteve. Gjykata e Lartë i është drejtuar babait të kërkuësve, me qëllim njoftimin e vendimit të revokimit me shkresën e datës 13.09.2022, e cila rezulton të jetë nënshkruar në datën 19.09.2022 nga shtetasja A.P. (me nënshkrimin “komshia”).

25. Gjithashtu, referuar të dhënave të publikuara në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë në rubrikën “Çështje të shpallura në gjykim”, konstatohet se në datën 13.09.2022 gjykata ka bërë shpalljen e listës së çështjeve civile për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 28.09.2022, ku përfshihet edhe çështja e kërkuësve, si dhe përbërjen e trupit gjykues.

26. Nga sa më lart, Kolegji vlerëson se babai i kërkuësve ka pasur dijeni për vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë që ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së palës paditëse në atë gjykim dhe anulimin pjesërisht të vendimit nr. 75, datë 21.03.1995 të KKKP-së, Vlorë, i cili kishte njohur atë si pronar. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, ky i fundit nuk ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, çka nënkupton se pretendimet e tij, të cilat lidhen me themelin e çështjes që ka vendosur mbi të drejtën e pronësisë, nuk janë paraqitur më parë në Gjykatën e Lartë, e cila duhet të ishte shprehur në lidhje me to. Gjithashtu, kërkuësit, si trashëgimtarë të R.F., kanë pasur mundësinë të parashtrojnë pretendimet e tyre për vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë edhe në momentin kur janë vënë në dijeni të vendimit të revokimit të kalimit të çështjes në seancë në Gjykatën e Lartë, por nuk e kanë ndërmarrë këtë veprim. Për më tepër, në lidhje me pretendimin se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në rekurs, kërkuësit nuk kanë sjellë asnjë argument nëse rekursi i ATP-së mbronte edhe të drejtat dhe interesat e tyre në çështjen konkrete.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.